



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106.1, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenin 26 të Ligjit nr. 03/L-072 të për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 01.12.2021, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale 2021 të Raundit të Dytë për Kryetar Komune në Prizren

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në Vendvotime dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Kryetar Komune të Raundit të Dytë në Prizren, të mbajtura me datën 14.11.2021.**
- II. **Kryetar Komune në Prizren, është zgjedhur Shaqir Totaj, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës - PDK, me 27,689 vota, në përqindje prej 50,93 %.**
- III. Rezultatet e zgjedhjeve si në pikën I, i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- IV. Këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- V. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që t'i publikojë në formë tabelare rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me këtë vendim.
- VI. Ky vendim, hyn në fuqi me 01.12.2021


Prishtinë, 01.12.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



PRIZREN/PRIZREN/PRIZREN



■ MYTAHER HASKUKA	49.1%
■ SHAQIR TOTALI	50.9%
Total:	100.0%

PRIZREN/PRIZREN/PRIZREN				
Emri/ Ime	Mbiemri/ Prezime	Emri i Partisë / Naziv Partije	Votave/Glasova	Përqindja/ Procentat
SHAQIR	TOTALI	177 PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	27 689	50,93%
MYTAHER	HASKUKA	144 LEVIZJA VETEVENDOSJE!	26 680	49,07%